

Mbahet debat me qytetarë për Planin Zhvillimor Komunal - 10 tetor 2012

Të mërkurën është mbajtur debati publik me qytetarë me temë: “ Hartimi i Planit Zhvillimor dhe Komunal” për Komunën e Kamenicës , i organizuar nga komuna e Kamenicës – Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në mbështetje të Projektit Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim – LOGOS.

Në emër të Kryetarit të komunës së Kamenicës z. Shaip Surdullit, i cili nuk kishte mund të marrë pjesë në këtë debat, fjalën e mori Drejtori i Drejtorisë së Administratës Enver Ajvazi i cili përshëndeti të pranishmit dhe LOGOS-in i cili ka ndihmuar në projektin e komunës tonë dhe Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Ai iu drejtua qytetarëve duke kërkuar edhe kontributin e tyre që do jetë një ndihmës për realizimin e këtij plani zhvillimor, po ashtu në këtë debat ju e keni mundësinë të bashkoheni në grupe punuese dhe në mënyrë sa më konstruktive të jepni mendimet, sugjerimet apo propozimet tuaja.

Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Kamenicës, është dokumenti më i rëndësishëm i komunës që përcakton kahet e zhvillimit të saj në 10 deri 15 vitet e ardhshme, andaj ky debat ka pas një rëndësi të veçantë që Plani Zhvillimor Komunal dhe për këtë arsye është mbajtur debati edhe me qytetarë, në mënyrë që ky plan të jetë në përputhje me interesat e përgjithshme të qytetarëve të komunës së Kamenicës.

Koordinatori i projektit LOGOS Norbert Pijls, tha se takimi i sotëm është i fundit në kuadër të asistencës sonë lidhur me Planin Zhvillimor për komunën e Kamenicës. Kemi pas një sërë takimesh në javët e fundit për këtë çështje dhe secili takim ka pas tema të ndryshme. Tema e parë për të cilën kemi biseduar ka qenë profili i komunës në lidhje me statistikat e komunës, demografin, infrastrukturën, e më vonë kemi diskutuar për vizionin e Kamenicës mbi zhvillimin e saj të ardhshëm. Ai po ashtu ceku se në takimin e fundit u sqarua se çfarë rëndësie do të ketë kjo në komunën tuaj. Ne sot do të fokusohemi në projekte që janë të përfshira në planin zhvillimor në 10 vitet e ardhshme që është e rëndësishme pjesëmarrja e juaj këtu, se këto projekte financohen edhe nga parat tuaja, kështu që duhet të sigurohemi që komuna të shfrytëzon këto para në interes të qytetarëve. Në këtë debat do të diskutojmë për prioritetet e projekteve se cili projekt do të shkojë i pari, por gjithashtu dhe ju keni mundësinë të propozoni dhe sugjeroni për ato projekte që mendoni se janë më prioritare.

Ndërsa, Suzana Goranci nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tha se ne kemi qenë prej fillimit të procesit të hartimit të këtij dokumenti të rëndësishëm, ku në të gjitha fazat kemi qenë pjesëmarrës që me komente, sugjerime dhe me këshilla profesionale ta ndihmojmë komunën që ky plan zhvillimor të zbatohet. Ajo gjithashtu ceku se Komuna e Kamenicës ka respektuar të gjitha procedurat ligjore gjithashtu i ka edhe parimet ndërkombëtare që parashihen në ligjin për planifikimin hapësinor, ku njëri prej parimeve ndërkombëtare është edhe transparenca dhe gjithë përfshirja prej bazës fillestare që parashihet sipas parimeve ndërkombëtare planifikimit strategjik, ju keni qenë pjesëmarrës të këtij procesi në hartimin e këtij dokumenti në planin zhvillimor komunal në Kamenicë.

Koordinatori i ekipit punues të planit Zhvillimor të komunës së Kamenicës Drejtori Ilir Kastrati tha se materiali është shume voluminoz. Ai përshkruajti kapitullin e vizionit, ku tha se është kapitulli kryesor ku përshkruhet e ardhmja e grupeve punuese, institucioneve, sektorëve dhe të gjithë qytetarëve të komunës.

Kastrati tha se duke vlerësuar Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal ky është një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Kamenicës në vitet e ardhshme me mundësi vazhdimi ne kemi menduar që të gjitha idetë që kemi pasur si grupe ti paraqesim në vizion, mirëpo gjithherë duke ju bazuar edhe planit të Kosovës.

Pas fjalimeve të mbajtura është bërë edhe prezantimi i këtij plani nga anëtarët e këtyre grupeve.

Nexhmije Kallaba Zyrtare për Integritim Evropiane njëherit anëtare e këtij grupi ka prezantuar zhvillimin ekonomik, si bujqësinë, zejtarinë, turizmin, energjinë dhe të tjera.

Ndërsa, drejtori i Administratës Enver Ajvazi ka paraqitur fushën tematike të demografisë dhe çështjeve sociale, strategjitë dhe veprimet për infrastrukturë sociale (fusha e demografisë dhe çështjeve sociale).

Ajvazi tha se ne kemi menduar që në vendbanimet apo lokalitete tona ku jetojmë, të ngritet sa më shumë mirëmbajtja e ambientit, pastaj këto projekte që i kemi menduar se do të realizohen të ardhmen do të trajtohen në një mënyrë ndjeshmërinë e banorëve për probleme sociale dhe kulturore etj.

Po ashtu edhe anëtarët të tjerë të këtij grupi punues kanë bërë prezantimin në pika të shkurtëra në lëmit që ata kanë punuar.

Në këtë debat qytetarët u ndanë në grupe punues ku dhanë edhe mendimet, propozimet, vërejtjet, sugjerimet e tyre lidhur me Planin Zhvillimor Komunal.

Pjesëmarrës në këtë tubim kanë qenë Përfaqësuesit e institucioneve komunale të Kamenicës, përfaqësuesit e projektit LOGOS, partive politike, organizatave dhe shoqatave joqeveritare, punëtorë të arsimit, afaristë, artisë, fermerë, sportistë, përfaqësues të shoqatave të grave, media dhe qytetarë të tjerë.